

REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE

Nr. Rendor	Data e kërkesës	Objekti i kërkesës	Data e përgjigjes	Përgjigje	Mënyra e përfundimit të kërkesës	Tarifa
01	30.06.2025	<i>Sa është vlera e dëmit të shkaktuar nga kundravajtësit , e konstatuar nga punonjësit e bashkive në Shqipëri për vitin 2022 deri 2024 ? (referuar evidencave që bashkitë raportojnë/dorëzojnë tek ju çdo 4 muaj) ?</i> <i>Sa nga kjo vlerë demi e viteve paraardhëse 2021-2022 është referuar për t'u kërkuar në Gjykata Civile, përsa i përket procesit të kerkimit të vlerës së dëmit të shkaktuar ndaj pronës publike në zbatim të të gjitha pikave të nenit 34 “Kontrolli i veprimtarive në fondin pyjor kombëtar”, të nenit 35, pika 1, gërma b, të ligjit nr.57/2020, dhe në referim të nenit 37, pika 1, mbështetur në parimin “dëmtuesi paguan”?</i> <i>Nëse psh, një bashki , nuk ka kërkuar pranë Gjykatave Civile apo Administrative asnjëherë në këto dy vite , vlerën e dëmit të shkaktuar ndaj pronës që bashkia monitoron , mbron apo administron , pronës që ne qytetarët i paguajmë me taksat për administrim dhe ruajtje, ndonjëherë edhe me numër punonjësish mbi 50 % më shumë se sa e përcakton neni 16, pika 3, duke shkelur kështu ligjin dhe ne paguajmë, por nuk marrim shërbimin në zbatim të neneve 34 “Kontrolli i veprimtarive në fondin pyjor kombëtar”, të nenit 35, pika 1, gërma b, të ligjit nr.57/2020 dhe në referim të nenit 37, pika 1, mbështetur në parimin “dëmtuesi paguan , cfarë</i>	24.07.2025	Përgjigja Nr. 1: Bashkitë kanë raportuar 12,510,519 lekë vlerë dëmi të shkaktuar në pyje gjatë vitit 2024. Kjo vlerë i referohet kryesisht prerjeve ilegale që në shumicën e rasteve rezultojnë pa autor. Përgjigja Nr.2: Në Agjencinë Kombëtare të Pyjeve nuk kemi të dhëna për referimin në Gjykatë të kerkimit të vlerës së dëmit të shkaktuar ndaj fondit pyjor dhe kullësor për vitet 2021 dhe 2022. Agjencia Kombëtare e Pyjeve gjatë viteve 2022-2024 i ka orientuar Bashkitë për kundërvajtjet me autor që t'i kryejnë të gjitha veprimet procedurale sipas legjislacionit në fuqi, ndërkohë që për çështjet administrative pa autor, i'u	E Plotë	0

		<i>masash ndërmerrni ju ? Drejtuar kujt institucionit apo personi pergjegjës?</i>	është kërkuar Bashkive evidentimi i këtyre rasteve dhe referimi i tyre në organet kompetente për klasifikimin sipas ligjit dhe nisjen e procedurave për gjetjen e autorit. AKP në bashkëpunim me inspektoriatin Qëndror ka unifikuar praktikat për kontrollin dhe procesin e inspektimit në fondin pyjor kombëtar nga strukturat përgjegjëse në ushtrimin e kompetencave të tyre, duke hartuar përmbajtjen dhe modelet e akteve për kundërvajtjet në pyje. Në zbatim të pikës pikës 8, të nenit 38, të ligjit nr. 57/2020, “Për pyjet”, me Urdhërin nr. 254, datë 11.08.2023, Ministri i Turizmit dhe Mjedisit ka miratuar përmbajtjen dhe modelet e akteve për kundërvajtjet në pyje. Referuar kërkesave zyrtare, si dhe detyrave të lëna në auditimet e performancës së Bashkive në zbatim të pikës 1 dhe 3, të nenit 16, të ligjit nr. 57/2020, “Për pyjet”, por jo vetëm, është kërkuar ngritja e strukturës përgjegjëse të pyjeve dhe ndarja e kësaj strukture në Sektorin e Menaxhimit me		
--	--	--	---	--	--

			inxhinierë pyjesh dhe Sektorin e Kontroll Inspektimit me inspektorë me arsim të lartë. Deri tani, pothuajse të gjitha Bashkitë, në saj dhe të presionit të vazhdueshëm nga ana jonë që përmbushin kriterin e sipërfaqes pyjore kanë Strukturë Inspektuese të ndarë nga Menaxhimi. Gjithashtu, është kërkuar që Struktura e Menaxhimit të ketë inxhinierë pyjesh dhe Sektori i Kontroll Inspektimit të jetë me inspektorë me arsim të lartë. Referuar shkronjës “ë”, të pikës 2, të nenit 15, të ligjit nr. 57/2020, “Për pyjet”, Agjencia Kombëtare e Pyjeve, pavarësisht mungesës së strukturës e konkretisht 4 degëve rajonale, si dhe mungesave në organikë ka garantuar funksionalitetin e sistemit të kontrollit dhe të inspektimit të veprimtarive që zhvillohen në fondin pyjor kombëtar, duke ndërhyrë për atë që ka qenë e mundur sipas përcaktimeve në këtë ligj, në ato Bashki të cilat nuk kanë strukturë inspektuese. I tillë është rasti i Kamzës, ku Bashkia nuk ka sipërfaqe pyjore në normën që kërkon		
--	--	--	--	--	--

			ligji por ndërkohë ka shumë subjekte që ushtrojnë aktivitetin e tyre në tregëtimin e lëndës drusore. Si rezultat i këtij inspektimi, në 12 subjekte në zbatim të legjislacionit në fuqi janë nxjerrë 5 vendime inspektimi, ku për tre subjekte të cilat operojnë në Bashkinë Kamëz është kërkuar në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë lëshimi i Urdhërit të Ekzekutimit të Titullit Ekzekutiv, Vendimit Përfundimtar të Inspektimit. Pavarësisht, se për Strukturën e Kontroll Inspektimit të AKP me dy inspektorë, ku inspektimi online është një komponent, në të cilin detyrimi kryesor është dhe mbetet kontrolli i përputhshmërisë së performancës së veprimtarisë së Bashkive me kërkesat ligjore të fushës së pyjeve, në zbatim të legjislacionit në fuqi dhe Programit Tematik Vjetor të Inspektimit për vitin 2024, të miratuar nga Inspektorati Qendror rezulton se ka vijuar puna në përmbushje të këtij programi. Janë trajnuar pothuajse të gjithë inspektorët e Bashkive për procedurat e inspektimit	
--	--	--	---	--

				on-line, si dhe kemi dhënë rast pas rasti asistencë ligjore e teknike për vijimin e zbatimit të ndryshimeve ligjore të fushës së inspektimit.		
--	--	--	--	---	--	--